



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E MBROJTJES



16-22 QERSHOR JAVA E MBROJTJES

MINISTRI VENUGU, VIZITË NË FRANCË

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, z. Pirro Vengu, zhvilloi një vizitë zyrtare në Francë, ku u takua me homologun, z. Sébastien Lecornu. Gjatë takimit, të dy ministrat ritheksuan angazhimin për zgjerimin e bashkëpunimit strategjik. Në kuadër të vizitës, Ministri Vengu mori pjesë në hapjen zyrtare të Panairit Ndërkombëtar të Aviacionit.

★★★★★

MBIKËQYRJE AJRORE ME RADAR

Në vijim të marrëveshjes dypalëshe të dakordësuar gjatë vizitës së Presidentit **Macron** në Tiranë muajin e kaluar, Forca Ajrore nënshkroi kontratën me kompaninë “**Thales Group**” për pajisjen me **radar** modern që do të përforcojë vëzhgimin e hapësirës ajrore kombëtare. Ky është një hap i **rëndësishëm** drejt **modernizimit** të kapaciteteve të mbrojtjes ajrore të Shqipërisë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



ME EMERGJENCAT CIVILE NË SHKODËR

Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, së bashku me kreun e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, **Haki Çako**, zhvilluan takime në Shkodër me **përfaqësuesit** e emergjencave civile rajonale. Qëllimi i këtyre takimeve ishte **forcimi** i zinxhirit të reagimit në rast emergjencash, **përmirësimi** i infrastrukturës parandaluese në **zonat** e thella dhe rritja e pranisë së Forcave të Armatosura në terren.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

RIKONSTRUKSIONI I SPITALIT TË TRAUMËS

Ministri i Mbrojtjes, **Pirro Vengu**, së bashku me Ministren e S hëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, **Albana Koçiu**, vizituan Spitalin Universitar të Traumës, ku ka nisur rikonstruksioni i Korpusit Qendror dhe sistemimi i ambienteve të jashtme. Projekti përfshin rehabilitimin e **5 godinave**, zgjerimin e hapësirave me mbi **15 mijë m²** dhe shtimin e kapaciteteve me 203 shtretër. Si strukturë civilo-ushtarake, **SUT** mbetet një kapacitet **strategjik** kombëtar në fushën e politraumës.

★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

AFA AKREDITOHET PËR 5 VITE

Me vendimin e Bordit të Akreditimit, Akademia e Forcave të Armatosura ka marrë akreditimin **institucional** për një periudhë **pesëvjeçare**, duke konfirmuar përmbushjen e **standardeve** të arsimit të lartë në vend. Ky është një hap i rëndësishëm drejt rritjes së **cilësisë** në arsimin ushtarak dhe kërkimin **shkencor**, në funksion të përgatitjes së studentëve dhe **oficerëve** të ardhshëm të Forcave të Armatosura.



FA NË MISION PËR SHUARJEN E ZJARREVE

Gjatë kësaj jave, efektivë të Detashmentit të Mbështetjes Rajonale Mengël, pjesë e Komandës Mbështetëse, u angazhuan në operacionin për shuarjen e zjarrit që përfshiu malin e Krastës. Falë ndërhyrjes së shpejtë dhe punës së pandërprerë së bashku me forcat operacionale, zjarri u vu nën kontroll dhe u izoluan plotësisht vatrat. Forcat e Armatosura treguan edhe një herë përkushtimin në mbrojtje të komunitetit dhe pasurive natyrore të vendit.

★★★★★



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



STËRVITJET “DURRËSI SAREX 25” DHE “REDONI BLU 25”

Me pjesëmarrjen e Forcës Detare, Forcës Ajrore, Policisë Kufitare dhe institucioneve të tjera, u zhvilluan me sukses stërvitjet “Durrësi SAREX 25” dhe “Redoni Blu 25”. Qëllimi i tyre ishte forcimi i bashkëpunimit dhe gatishmërisë për operacione kërkim-shpëtimi dhe reagim ndaj ndotjeve në det, duke garantuar sigurinë në hapësirën detare të Shqipërisë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

AFA FITON VENDIN E PARË NË GJILAN

Një ekip përfaqësues i Akademisë së Forcave të Armatosura mori pjesë në edicionin e katërt të “Gjilani Half Marathon 2025”, i zhvilluar në nder të Dëshmorëve, me ftesë të komunës së Gjilanit. Nënkolonel Bledar Mesi, përfaqësues i AFA, u rendit në vendin e parë në garën 10 km, duke sjellë një tjetër vlerësim të rëndësishëm për Akademinë dhe Forcat e Armatosura.

